



UNIVERSITETI "ALEKSANDËR MOISIU" Durrës
KOMISIONI INSTITUCIONAL I ZGJEDHJEVE

Prot. 179 Nr.

Durrës, më 9 / 10 / 2023

V E N D I M

Nr. 23, datë 9 / 10 / 2023

**"PËR SHTYRJEN E AFATIT TË PROCESIT TË APLIKIMEVE PËR ANËTAR TË
KOMISIONIT TË INTEGRITETIT AKADEMIK TË FAKULTETIT TË BIZNESIT NË
UNIVERSITETIN "ALEKSANDËR MOISIU", Durrës "**

Në mbështetje të ligjit, Nr. 80/2015, datë 17/09/2015 "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë", neni 46 i Statutit dhe të Rregullores së UAMD-së, të Rregullores "Për organizimin e zgjedhjeve për Autoritetet dhe Organet Drejtuese në Universitetin "Aleksandër Moisiu" Durrës", e miratuar me vendim Senati Akademik nr.43, datë 11.02.2020, Vendimit të Senatit Akademik Nr. 52 datë 11.09.2023 "Mbi ngritjen e Komisionit të Integritetit Akademik të Fakultetit të Biznesit (KIAF)", Urdhërit të Rektorit nr.343, datë 27.09.2023 "Shpalljen e zgjedhjeve për anëtarë të Komisionit të Integritetit akademik të Fakultetit të Biznesit, në Universitetin "Aleksandër Moisiu", Durrës", Komisioni Institucional i Zgjedhjeve,

VENDOSI:

1. Shtyrjen e afatit të procesit të aplikimeve për anëtar të Komisionit të Integritetit Akademik të Fakultetit të Biznesit (KIAF) në Universitetin "Aleksandër Moisiu" Durrës.
2. Regjistrimi i kandidatëve do të zhvillohet nga data 09.10.2023 deri në datën 13.10.2023, orari 08.00 - 16.00, pranë sekretarisë KZF, zyra B 201, Godina Nr 2. Fakulteti i Biznesit.
3. Bashkëlidhur vendimit dokumentacioni i cili do të dorëzohet për aplikim.
4. Data e zhvillimit të zgjedhjeve do të jetë 27.10.2023.
5. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.





UNIVERSITETI "ALEKSANDËR MOISIU" DURRËS
KOMISIONI INSTITUCIONAL I ZGJEDHJEVE

KËRKESË PËR KANDIDIM

PËR ANËTAR TË KOMISIONIT TË KOMISIONIT TË INTEGRITETIT AKADEMIK
TË FAKULTETIT TË BIZNESIT NË UAMD

Unë i/e nënshkruar/a _____, lindur më ____/____/____, në
_____, të rrethit _____, gjinia _____, staf akademik në
Departamentin _____, Fakulteti _____ paraqes kërkesën time për të
kandiduar si anëtar i Komisionit të Integritetit akademik të Fakultetit të Biznesit në Universitetin
"Aleksandër Moisiu" Durrës.

Deklaroj nën përgjegjësinë time personale se:

- a. Nuk jam dënuar asnjëherë gjatë jetës time, me vendim gjyqësor të formës së prerë për ndonjë vepër penale.
- b. Nuk kam asnjë shkak për të qenë objekt i ligjit nr. 136/2015 "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike"
- c. Nuk kam asnjë shkak për të qenë objekt i ligjit 45/2015 "Për të drejtën e informimit për dokumentat e ish-sigurimit të shtetit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë.
- d. Nuk është caktuar ndaj meje asnjë nga masat e sigurimit personal
- e. Nuk është dhënë ndaj meje asnjë mase disiplinore e cila është në fuqi

Kësaj kërkesë i bashkangjitet, kopja e kartës së identitetit/pasaportës, kopja e noterizuar e titullit _____ që unë zotëroj, vërtetimi i qendrës time të punës, vetëdeklarimi për integritetin e lartë akademik, vetëdeklarimi gjendjes gjyqësore.

Për sa deklaroja në këtë kërkesë mbaj përgjegjësi personale dhe autorizoj Komisionin Institucional të Zgjedhjeve të bëjë verifikimet që ai i konsideron të nevojshme.

Aplikuesi

U dorëzua sot, më datën _____, në zyrën _____, tek sekretaria e KZF _____, (firma)



UNIVERSITETI "ALEKSANDËR MOISIU" DURRËS
KOMISIONI INSTITUCIONAL I ZGJEDHJEVE

Dokumentacioni për kandidim:

- a) Kërkesën për kandidim, e cila përmban, emrin; atësinë; mbiemrin; datëlindjen; gjininë; shprehjen e vullnetit për kandidim;
- b) Vetëdeklarim për integritetin e lartë akademik të kandidatit
- c) Deklarimin që nuk është i dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për vepra penale;
- d) Deklarimin se nuk ka shkak për të qenë objekt i ligjit nr. 138/2015 "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike" dhe ligjit nr. 45/2015 "Për të drejtën e informimit për dokumentet e ish-sigurimit të shtetit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë";
- e) Kopje të dokumentit të identifikimit;
- f) Kopje të noterizuar të titullit akademik "Profesor" ose "Profesor i asociuar", gradës shkencor edhe diplomës/diplomave të arsimit të lartë;
- g) Fotokopje të noteruar të librezës së punës.(Vërtetimi i punës)